



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë; Tel-Fax: 0693067738

E-mail: rmuca@klsh.org.al; Web-site: www.klsh.org.al

Auditim performance: "TRASHËGIMIA KULTURORE"

Përmbledhje Ekzekutive

Në zbatim të planit vjetor 2014, Kontrolli i Lartë i Shtetit, në kuadër të përmbushjes së funksionit të tij Kushtetues, zbatimit të Udhëzimeve dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI, EUROSAI, ndërmori auditimin e me temë "Menaxhimi i Trashëgimisë Kulturore".

Ky auditim u programua për t'u ushtruar në Ministrinë e Kulturës, Agjencinë e Shpëtimit Arkeologjik dhe Institutin e Monumenteve të Kulturës. Pas përfundimit të punës paraprake audituese, me shkresën nr. 709/2, datë 03.11.2014, u miratua programi auditimit. Në përfundim të punës audituese në terren, me shkresën nr. 709/3, Projektraporti auditimit iu është përcjellë 3 grupeve të ndryshme interesi për fokusin e auditimit. Nga palët e interesit u kthyen observacionet me shkresat nr. 1465/1, nr.1969 dhe nr.210/2, të datave 17.04.2015 të cilat u pasqyruan në hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit me sqarimet përkatëse.

Në përfundim, pasi Kryetari u njoh me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Performancës, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e kontrollit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Drejtorisë Juridike, Kontrollit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut, në mbështetje të nenit 25/ç të ligjit nr. 154/2014, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

K O N K L U D O I:

Për Ministrinë e Kulturës, Agjencinë e Shpëtimit Arkeologjik dhe Institutin e Monumenteve të Kulturës:

Në parim, mbrojtja e TK përfaqëson një veprim publik. Për këtë arsye, vendimet që merren në këtë fushë duhet të pranohen si veprime në favor të publikut dhe të shoqërisë. Pranimi i disa rregullave është i nevojshëm për të siguruar mbrojtjen e TK kundër interesave private. Aktivitetet tregtare dhe ndërtimet janë lejuar në shkelje të rregullave, të cilat rezultuan në prishje të zonave arkeologjike të mbrojtura dhe në lënien pas dore të monumenteve. Mirëmbajtja e muzeumeve arkeologjike është

pre e mungesës së fondeve. Ndjekja e ndërhyrjeve të paligjshme në qendra dhe zona të TK dhe në zona me potencial arkeologjik ka qenë e pamjaftueshme, kjo edhe për mungesë të bashkëpunimi ndërinstitucional dhe bashkëpunimit ndër vite dhe ruajtjes së marrëdhënieve me pushtetin lokal, pa të cilin është e pamundur të ruhet e të mbrohet TK.

Kjo situatë ka ardhur edhe si pasojë e mungesës së një strategjie dhe formulimit të objektivave dhe prioriteteve të qarta në mbrojtje të TK. Mbrojtja dhe ruajtja e TK, supozon vendosjen e parimeve etike, të mbështetura nga instrumente normative dhe të përforcuara nga përgjegjësia kolektive e vepruesve.

Mesazhi për këtë auditim performance është: *“Për periudhën e audituar, pak është bërë nga entet përgjegjëse shtetërore në miratimin e politikave dhe monitorimin e vazhdueshëm të proceseve për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Trashëgimisë Arkeologjike dhe asaj Monumentale, pasuri e brezave, si detyrimi ynë madhor kundrejt së shkuarës dhe së ardhmes”.*

Nisur nga konkluzionet mësipërme dhe rezultatet e punës audituese, duke synuar përmirësimin e mëtejshëm të trashëgimisë kulturore, Kryetari i KLSH-së:

V E N D O S I:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit të performancës “Menaxhimi i Trashëgimisë Kulturore”.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

1. Edhe pse për periudhën 2012-2014, ministria ka hartuar dokumente strategjike, ato nuk janë miratuar, duke mos gjetur zbatim në ruajtjen, mbrojtjen dhe kujdesin e TK kombëtare. Pra, aktualisht MK nuk ka një Strategji dhe prioritetet kryesore të punës së saj parashtrohen në fjalën e Ministres së Kulturës. Gjithashtu, MK nuk ka një Plan të Përgjithshëm Kombëtar në fushën e TK, por plane veprimi në bazë të programit të qeverisë. Aktualisht, sipas MK zbatohet plani i veprimit “300 ditët” për periudhën korrik 2014 – prill 2015, në të cilin janë vendosur objektivat dhe afatet kohore për arritjen e tyre. Ministria në kuadër të PPK, tashmë ka nisur procesin e hartimit të një Strategjie Kombëtare për Kulturën dhe TK, për periudhën 2014-2020.

MK urgjentisht duhet të hartojë një politikë afatgjatë për të siguruar mbrojtjen dhe promovimin e turizmit kulturor, përfundimin e katalogimit dhe paraqitjes së vlerave kulturore të Shqipërisë, krijimin e lehtësive për publikun që të njohë e shfrytëzojë pasuritë kulturore. Nëpërmjet politikave afatgjatë ajo duhet të synojë ndërtimin e një sistemi menaxhimi modern të TK duke përfshirë restaurimin dhe konservimin e monumenteve në planet urbanistike e mjedisore, rehabilitimin e qendrave e qyteteve muze dhe përmirësimin e vazhdueshëm të infrastrukturës, me qëllimin për t'i shndërruar ato në qendra të hapura ndaj vizitorëve vendas dhe të huaj. Përmirësimet ligjore dhe zbatimi i sanksioneve duhet të sigurojnë një mbrojtje efikase për TK, duke mos lejuar ndërtimet pa leje në zonat e mbrojtura si dhe duke denoncuar lejet e dhëna në kundërshtim me ligjin për TK. Rëndësi duhet t'i kushtohet edhe rivendosjes së besimit në kapacitetin e strukturave shtetërore dhe bashkëpunimit me pushtetin vendor dhe institucionet shkencore të vendit për ruajtjen, studimin dhe mirë-menaxhimin e TK.

“Menjëherë”

2. Që nga krijimi i saj, ASHA nuk ka patur *Strategji Zhvillimi afatmesme apo afatgjatë* dhe plan veprimi të mirëfilltë. Gjithashtu, nxitur nga zhvillimet dhe problemet themelore të kërkimit shkencor arkeologjik, ajo nuk ka propozuar hartimin e *Strategjisë së Integritit të Kërkimit*

Arkeologjik. Mospasja e një strategjie të qartë ka bërë që ASHA të mos evoluojë një politikë afatgjatë për ruajtjen, mbrojtjen e TA, pasi një nga aspektet më të rëndësishme të funksionimit mirë të një institucioni, është procesi i planifikimit. Është e rëndësishme të theksojmë se masat e deritanishme të përdorura për mbrojtjen e TA në procesin e planifikimit nuk janë marrë aspak Sipas strukturave të saj, hartimi i strategjisë përbën një ndër përparësitë e veprimtarisë së saj në vijimësi. Veprimtarinë e saj, ASHA e ka mbështetur në “Objektivat për të ardhmen” të cilat janë edhe detyrat e saj funksionale të pasqyruara në “Raportet Vjetore të aktivitetit”. Këto objektiva nuk ishin të shoqëruara me afate të mirëpërcaktuara dhe me ndarje përgjegjësish të burimeve njerëzore. Përpara krijimit të ASHA-s, detyrat e arkeologjisë së shpëtimit kryheshin nga një sektor i vetëm, mjaft efikas në varësi të Institutit të Monumenteve të Kulturës.

ASHA duhet të hartojë një politikë afatgjatë për të siguruar identifikimin, shpëtimin, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e gjetjeve arkeologjike. Në këtë kuadër hartimi i strategjisë do të siguronte arritjen më lehtë të objektivave të themeluara, të tilla si organizimi kërkimeve, sigurimi i zbulimeve dhe rezultateve të gjetjeve. Kjo do të ndihmojë stafin në kryerjen e funksioneve të tij në mënyrë të fokusuar dhe efektive, sipas një Strategjie dhe Plani Veprimi të hartuar dhe të mirë-përcaktuar qartë, duke marrë në konsideratë edhe përplasjet e kompetencave të ASHA-s me Institutin e Arkeologjisë-IA.

“Menjëherë”

3. ASHA nuk i ka arritur objektivat për të cilat është ngritur si institucion në drejtim të mbikëqyrjes arkeologjike për projektet e mëdha të infrastrukturës me qëllim mbrojtjen e TA. Duke mos realizuar mbikëqyrjen, ASHA nuk do të mund të përmbushë objektivin e saj për të cilin është krijuar. Nuk ishte funksional një sistem efektiv monitorimi. ASHA nuk ka miratuar një sistem të duhur të monitorimit për ruajtjen, mirëmbajtjen e punimeve dhe sigurinë e gjetjeve arkeologjike gjatë procesit të ndërtimit. Punimet nuk ishin mbikëqyrur, pasi ASHA nuk dispononte raporte të tilla as nga ajo vetë dhe as nga DRKK. Pra askush nuk inspektonte dhe mbikëqyrte pas marrjes së miratimit në KKA, veprat e projekteve të mëdha në të gjithë Shqipërinë.

ASHA duhet që për skemat e zhvillimit publike ose private, të sigurojë mbikëqyrje arkeologjike dhe regjistrimin e plotë të zbulimeve. Mbikëqyrja nuk mund të neglizhohet dhe për këtë ASHA duhet të zhvillojë një mekanizëm të vazhdueshëm të monitorimit efektiv për të mundësuar arritjen e objektivave të veta në ruajtjen dhe mirëmbajtjen e gjetjeve arkeologjike. Në zonat e ndjeshme arkeologjike në zhvillim infrastrukturor, duhet të jetë një mbikëqyrës në vendin e ndërtimit nga ASHA apo DRKK, për të siguruar orientimin në terren para fillimit të projektit të zbatimit. Mbikëqyrësit duhet të caktohen me detyra dhe përgjegjësi të shprehura në një marrëdhënie kontraktuale, për të siguruar dhe përmbushur të gjitha kërkesat dhe legjislacionin rregullator për arkeologjinë. Në këto raste do të ishte me shumë vend kryerja e një supervizioni apo mbikëqyrjeje edhe nga stafi i sektorit të Arkeologjisë së shpëtimit, për të gjitha veprat e mëdha infrastrukturorë. Vlen të theksohet që strukturat e arkeologjisë së shpëtimit do të ishte mirë të jenë pjesë përbërëse e DRKK-ve dhe jo një strukturë e vetme si ASHA e cila qartazi nuk mbulon dot territorin e vendit me personelin dhe shërbimin e saj.

“Vazhdimisht”

4. ASHA nuk ka një **sektor të auditimit të brendshëm**. Ajo nuk është audituar më parë për efektivitetin e “Sistemit të menaxhimit arkeologjik”. Gjithashtu ajo nuk **është audituar apo monitoruar** rregullisht për sistemin e menaxhimit arkeologjik as nga ministria. Në botë, në lidhje me zhvillimet infrastrukturorë kryhet një auditim vjetor në kompanitë e përzgjedhura në mënyrë rastësore, për të vlerësuar efektivitetin e tyre në “Sistemet e menaxhimit arkeologjik”, bazuar në një Program të Auditimit Arkeologjik. Ky auditim, është një proces sistematik që mbështetet në parimet e pavarësisë dhe objektivitetit.

Krijimi i një Programi të Auditimit Arkeologjik si një komponent i nevojshëm, do të kërkonte një strategji të plotë për propagandimin e vlerave të TA. Nën një politikë afatgjatë, MK në bashkëpunim me ASHA, të gjejë mundësinë e hartimit dhe përfshirjes së një “Programi Auditimi mbi Arkeologjinë” në Strategjinë Sektoriale të MK.

“Vazhdimisht”

5. ASHA është institucion buxhetor, i cili mund të marrë donacione dhe sponsorizime të ndryshme. Mbështetja financiare publike nga autoritetet kombëtare, rajonale dhe lokale në pajtim me kompetencën e tyre, është shumë e rëndësishme pasi i obligon ata të jenë përgjegjës për projekte arkeologjike. Trashëgimia arkeologjike është "një burim i historisë kolektive Evropiane" dhe sipas fjalëve të shkruara në Kartën IKOMOS ajo është "e përbashkët për tërë shoqërinë njerëzore". Prandaj buxheti i shtetit duhet të mbulojë fazën e vlerësimit, mbledhjes së të dhënave dhe identifikimit të zonave me potenciale arkeologjike.

-Me qëllim rritjen e efikasitetit të përdorimit të burimeve financiare dhe njerëzore, ASHA duhet të llojë për burime të brendshme dhe të jashtme financimi.

-Autoritetet kombëtare, rajonale dhe lokale në pajtim me kompetencat e tyre përkatëse duhet të sigurojnë mbështetje financiare publike për kërkime arkeologjike. Financimi i kërkimeve, konservimit arkeologjik, arkeologjisë së shpëtimit duhet të parashikohet në skemat madhore të zhvillimit dhe duhet të mbulojë me burime materiale të gjitha shpenzimet e kryera për çdo operacion të nevojshëm që lidhet me arkeologjinë. Në këtë kuadër MK duhet të bashkëpunojë me autoritet kombëtare rajonale në planifikimin e buxheteve për të mbuluar fazën e vlerësimit, mbledhjes së të dhënave dhe identifikimit të zonave me potenciale arkeologjike.

“Vazhdimisht”

6. ASHA nuk ka patur një bashkëpunim më të gjerë mbi arkeologjinë me institucione ndërkombëtare evropiane, qëllimi i të cilave është shqyrtimi i mënyrave të ndryshme parandaluese apo shpëtuese për veprimtaritë arkeologjike, sipas modeleve në të gjithë Evropën, si edhe për të konsideruar sfidat dhe përfitimet e shtetit dhe arkeologjisë private apo asaj tregtare. Rezultati i pritshëm nga bashkëpunimi do të kishte qenë një mirëkuptim më i madh i përbashkët i përfitimeve dhe sfidave me të cilat përballet sot realiteti shqiptar dhe qasjet e marra nga shtetet evropiane do të kishin informuar qeverinë për të përforcuar këshillat mbi aplikimin ose ndryshimin e politikave. Njohja me kornizën ligjore dhe organizative për modele të ndryshme të arkeologjisë parandaluese të zbatuara në të gjithë Evropën do të realizohej nëpërmjet bashkëpunimit.

Rritja e shkëmbimeve kombëtare dhe ndërkombëtare të personave të profesioneve dhe zanateve të ndryshme, të përfshirë në konservimin/ruajtjen e TA do të trajnonte sektorë të ndryshëm e profesionalë të ASHA-s. I përket MK të sigurojë se nuk ekziston asnjë pengesë për shkëmbime të tilla kombëtare ose ndërkombëtare.

Pra nga MK kërkohet të punojë pozitivisht për të themeluar një klimë të favorshme për kryerjen e shkëmbimeve, siç është për shembull: themelimi i marrëveshjeve dypalëshe dhe procedurave që lehtësojnë këtë proces.

“Vazhdimisht”

7. ASHA nuk ka në përbërje të saj apo të kontraktuar prej saj, specialistë të çdo periudhe si: Paleolitit, Mesolitit, Neolitit, Bronzi, Hekuri, Antikiteti, Mesjeta etj. Gjithashtu ajo nuk disponon teknologjitë më të përparura në punën e saj të përditshme. Edhe pse ajo ka funksion kryesor të veprimtarisë së saj “Gërmime arkeologjike shpëtimi” dhe “Vëzhgime arkeologjike sipërfaqësore” (survey) ato nuk janë kryer vetëm nga stafi i ASHA, por janë kryer në bashkëpunim me IA. Mungesa e diversitetit të ekipeve të ASHA-ës dhe stafi i pakët i saj, nuk e mundëson atë për të vendosur spektrin e plotë të aftësive të hulumtimit modern arkeologjik.

Gërmimet arkeologjike dhe kërkimet të kryhen në mënyrë shkencore dhe me kusht që të zbatohen, aty ku është e mundur, metoda jo shkatërruese investigimi. ASHA duhet të sigurohet që gërmimet

të kryhen vetëm nga persona të kualifikuar dhe posaçërisht të autorizuar për të shmangur teknikat e tjera “potencialisht shkatërruese”.

Përpjekjet e ASHA për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e gjetjeve duhet të udhëhiqet nga këshilla të ekspertëve. Për këtë qëllim ASHA mund të propozojë ngritjen e një Bordi Këshillimor duke përfshirë personalitete të shquar qytetarë dhe ekspertë në këtë fushë në mënyrë që të jepen këshillat e duhura që mund të kërkohen në çështjet gërmimit, ruajtjes, mbrojtjes, mirëmbajtjes etj të gjetjeve arkeologjike dhe pasurimit të muzeumeve me to. I përket MK më pas të hartojë dhe të kërkojë miratimin e akteve normative në mbështetje të krijimit të “Bordit këshillimor”.

“Vazhdimisht”

8. Problemi vendimtar për ruajtjen e TA ka të bëjë me informimin publik. E tërë puna arkeologjike bëhet në të mirë të publikut dhe i bën njerëzit të kuptojnë se përmes kësaj pune krijohet historia dhe ndriçohen krijimet e civilizimeve të kaluara. Interesi i publikut duhet të kultivohet dhe të rritet. Kjo jo vetëm që shpie në krijimin e një publiku më të edukuar dhe të arsimuar, por gjithashtu kontribuon në vetë mbrojtjen më të lartë të TA. Vetëdija e publikut mbi vlerën e kësaj trashëgimie bën që ky publik të jetë më pak i vullnetshëm për shkakimin e dëmeve ose shkatërrimeve dhe një publik i tillë gjithashtu mund të përgatitet të ofrojë resurse për nxjerrjen e informacioneve të mëtejme lidhur me trashëgiminë. Në mënyrë që vlera e TA të çmohet tërësisht, publiku duhet të ketë qasje në tërësitë dhe objektet arkeologjike. Kjo është një pjesë kyçe e procesit të edukimit dhe një metodë themelore për të ndihmuar në të kuptuarit e origjinave dhe të zhvillimit të shoqërive bashkëkohore.

ASHA duhet të zbatojë masa edukative me synim rritjen dhe zhvillimin e ndërgjegjësimit në opinionin publik mbi vlerat e TA për kuptimin e të kaluarës dhe mbi kërcënimet që i kanosen kësaj trashëgimie, si dhe edukimin e publikut për TA, si një element i rëndësishëm i identitetit kulturor.

“Menjëherë”

9. Duhet themeluar një sistem ligjor për mbrojtjen e TA dhe duhet të aplikohet një inventar në të cilin të regjistrohet TA. Të dyja këto janë elemente themelore në procesin e planifikimit, pasi që të dyja mundësojnë që projektet gjatë fazës së formulimit të marrin parasysh edhe TA. Inventari ka shumë për të treguar se ku ka TA. Pasi të jenë gjetur objektet, përfshirja e tyre në inventar duhet të nënkuptojë që vendndodhja e tyre është e njohur. Kjo lejon që kushtet fizike të objektit të monitorohen po që se kjo është e dëshirueshme.

Me qëllim ruajtjen e dëshmive materiale për t’u studiuar nga brezat e ardhshëm, e rëndësishme është mbajtja e një inventari mbi TA. Caktimi i monumenteve dhe zonave të mbrojtura të tyre është i dobishëm pasi vetëm kështu kuptojmë se deri ku shtrihet hapësira/shtrirja e zonës ose e monumentit. Rezervat arkeologjike janë sipërfaqe tokësore, me kufij të caktuar në mënyrë që të ruhet/konservohet TA e cila ndodhet përbrenda këtyre kufijve.

Për këtë ASHA duhet të përditësojë studimet, inventarët dhe hartat e vendeve arkeologjike brenda territorit të RSH-së, që të lehtësohet studimi dhe shpërndarja e informacionit për zbulimet arkeologjike.

“Menjëherë”

10. Në vendin tonë është i njohur fakti i gërmimeve të paligjshme nëpër qendrat arkeologjike historike, apo i kërkimeve nënujore të kryera nga shtetas shqiptarë apo të huaj, të cilët kanë për qëllim: gjetjen përvetësimin dhe trafikimin e veprave të artit jashtë shtetit. Ndërkohë media dhe forumet, përditë ngrenë probleme me të dhëna për ndërtime të reja, me ose pa leje nga organet kompetente mbi zona të pasura me materiale arkeologjike të cilat kanë vlera për TK. Është e pamundur të bëhet parandalimi i tërësishtëm i largimit të elementeve të TA nga tërësitë e tyre dhe ndërtimit pa leje në zona arkeologjike, përveç se kjo nuk ndëshkohet me ligj. Por nga ana tjetër vlera e shitjes së shumë objekteve është aq e lartë në tregjet evropiane sa keqberësit për shkak të

lakmisë ndaj këtyre objekteve, mund të mos përfillin dënimet dhe në këtë mënyrë të shmanget mbrojtja e tyre.

-ASHA duhet të zhvillojnë një plan të menaxhimit të burimeve arkeologjike dhe formatizimin e procedurave standarde operative të cilat tashmë nuk janë në përdorim. Plani i menaxhimit duhet të jetë i adresuar dhe të përfshijë kërkesat legislative dhe rregullatore, proceset për sigurimin e përfundimit të vlerësimeve arkeologjike dhe dorëzimin në kohë të raporteve arkeologjike tek sektori kontrollues për të siguruar se të gjitha kërkesat arkeologjike janë përfunduar para aktiviteteve ndërtimore. Në këtë kontekst MK duhet të mbështesë ASHA për TA dhe krijimin e strukturave administrative të afta për t'u marrë me projekte zhvillimi, përfshirë të dhënat arkeologjike, miratimin e masave ligjore dhe administrative të nevojshme, krijimin dhe formulimin e inventarëve arkeologjikë dhe bazës së të dhënave, në mënyrë që të dhënat arkeologjike të merren parasysh si çështje e një vazhdimësie në procesin e planifikimit urban dhe rural

-Në kuadër të praktikave bashkëkohore dhe marrëdhënies ndërmjet projekteve për zhvillim dhe ruajtje të TA, nga MK kërkohet të përfshijnë arkeologë gjatë tërë procesit të planifikimit dhe të sigurojnë një konsultim ndërmjet arkeologëve dhe planifikuesve urban dhe rajonal. Gjithashtu planifikuesit urbanë dhe rajonalë të konsultohen në mënyrë sistematike me njëri-tjetrin për të lejuar modifikimin e planeve të zhvillimit në mënyrë që të mos kenë efekte negative mbi TA dhe të sigurohen që janë kryer vlerësimet mbi ndikimet mjedisore duke marrë tërësisht në konsideratë vendet arkeologjike dhe mjediset e tyre.

“Vazhdimisht”

11. Shtimi i kërkimeve arkeologjike në të gjithë territorin e vendit, bashkëpunimi i ngushtë me organizma prestigjiozë në fushën e kërkimit dhe veprimtarisë shkencore është i pamjaftueshëm. Shtimi i kontrollit mbi territorin, si dhe menaxhimi i pasurisë arkeologjike në përputhje me parimet e njohura ndërkombëtarisht, duhet të jenë prioritetet themelore të veprimtarisë së ASHA dhe të gjitha institucioneve shtetërore në këtë fushë. Paraqitja e praktikave më të mira dhe të këqija nga vendet evropiane dhe përfitimet aktuale të arkeologjisë parandaluese duhet të jenë pjesë e realitetit të vendit tonë. Disa çështje duhen adresuar nga përvoja e vendeve të tjera të tilla, si: gjetja, ekspertiza e duhur, monitorimi i vazhdueshëm për të ruajtur dhe mbrojtur TA dhe e fundit, por jo më pak e rëndësishme sigurimi i përfitimit publik nga kjo trashëgimi. Shumë pak përparim është bërë në fushën e gërmimeve të shpëtimit.

-Për ruajtjen e TA dhe garantimin e ***rëndësisë shkencore të punëve studimore arkeologjike***, duhet të zbatohen procedura për autorizimin dhe mbikëqyrjen e gërmimeve dhe veprimtarive të tjera arkeologjike në mënyrë të tillë që të parandalojnë çdo gërmim të paligjshëm apo zhvendosje elementesh të TA. ASHA në bashkëpunim me MK dhe DRKK, duhet të organizojë për autoritetet publike përkatëse dhe për institucionet shkencore mbledhjen e informacionit mbi çdo gërmim të paligjshëm të identifikuar.

-ASHA duhet të kufizojë, sa të jetë e mundur, nëpërmjet edukimit, informimit, vigjilencës dhe bashkëpunimit, transferimin e elementeve të TA, të përfuara nga gjetjet e pakontrolluara apo gërmimet e paligjshme, apo gërmimet zyrtare në mënyrë të paligjshme.

“Vazhdimisht”

12. Funkzioni parësor i IMK, i cili ka të bëjë me evidentimin, gjurmimin, studimin, konservimin, dhe restaurimin e veprave të artit dhe monumenteve të tjera të TK, nuk udhëhiqet nga një parashikim rezultatesh që pritet të arrijë kjo njësi. Mungesa e një baze të dhënash të plota e të përditësuar për vendodhjet dhe gjendjen e monumenteve të kulturës, si dhe zvarritja e procesit të pasaportizimit të tyre, ka bërë që ndërhyrjet në monumente të mos realizohen sipas nevojës dhe në shumë raste këto monumente janë dëmtuar tërësisht, duke u hequr nga lista e monumenteve të kulturës.

IMK të përcaktojë qartë një sistem menaxhimi për monumentet, të cilit t'i përmbahet me rigorozitet, sipas rradhës: Identifikimi, Planifikimi, Menaxhimi, Monitorimi dhe Raportimi. Kjo rradhë, të shoqërohet me plane strategjike, identifikim prioritetesh dhe përcaktim të qartë objektivash. Gjithashtu, të merren masa që IMK të planifikojë një hartë risku, e cila të përmbajë listën e monumenteve më të rrezikuara, si dhe ta përditësojë atë në vazhdimësi, pas çdo ndërhyrjeje.

“Menjëherë”

13. Për periudhën e audituar, vërehet një angazhim i dobët, për shfrytëzimin e monumenteve për evente kulturore. Mungesa e këtyre aktiviteteve, sjell dhe mos promovimin e këtyre monumenteve, duke i lënë ato në harresë e duke ulur shkallën e tyre të atraktivitetit. Nuk ka patur një bashkëpunim frytdhënës me njësitë vendore përgjegjëse për rregullimin e territorit, të cilat nëpërmjet ndërhyrjeve dhe dhënies së lejeve të ndërtimit të pa ligjshme në zonat e mbrojtura, kanë cenuar gjendjen e monumenteve të kulturës. Rëndësia e ekzistencës dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore në thelb ka të bëjë me gjenerimin e përfitimeve ekonomike, sociale dhe mjedisore, përfitime të cilat kanë rezultuar shumë të vakëta për periudhën në auditim për shkak të: mungesës së bashkëpunimit ndërinstitucional, mungesës së kapaciteteve profesionale në strukturat që menaxhojnë fondet e TK, mungesës së një kuadri ligjor detyrues në këtë drejtim për të gjithë institucionet që administrojnë fonde të TK, si dhe mungesës së një mbështetjeje institucionale nga strukturat më të larta të sistemit të trashëgimisë për të imponuar tek institucionet e varësisë zbatimin e ligjit për këtë çështje.

-Duke marrë parasysh masën e vogël të fondeve në dispozicion për ndërhyrje dhe numrin e lartë të objekteve monument kulture, MK, së bashku me IMK dhe DRKK përkatëse, të marrin masa për hartimin edhe të projekteve apo ideve për promovimin e monumenteve, krahas projekteve për ndërhyrjet në monumente, në mënyrë që të rritet vizitueshmëria e tyre, duke gjeneruar kështu më tepër të ardhura nga to. Po në këtë kontekst, në mungesë të fondeve të nevojshme akorduar mirëmbajtjes dhe ndërhyrjes në monumente, IMK në bashkëpunim me MK, të llobojnë nëpërmjet argumenteve bindëse cilësore dhe sasiore për përvetësimin e masës së parashikuar nga ligji prej 90% të të ardhurave të gjeneruara nga vizitat në monumente.

-Në përmbushje të rekomandimit të më sipërm, lidhur me rritjen e vizitueshmërisë së monumenteve të kulturës, IMK të përshpejtojë procedurat që lidhen me identifikimin, kartelizimin, përpilimin e dosjeve elektronike me të gjithë bazën e të dhënave për çdo monument, të përfundojë shpalljen e zonave të mbrojtura dhe mbi të gjitha, të marrë masa për shënjimin dhe pajisjen me tabelat dhe sinjalistikën informuese përkatëse, për të lehtësuar dhe shtuar vizitueshmërinë e këtyre monumenteve nga vendas dhe të huaj.

“Menjëherë”

14. Deri më sot nuk ekziston një akt normativ i cili të rregullojë përbërjen dhe numrin e anëtarëve të KKR dhe KSH.. Lëvizjet e shpeshta dhe përbërja jo konstante e organeve këshillimore dhe vendim-marrëse të IMK, nuk kanë rezultuar efektive. Realizimi i funksioneve të KKR pa u bazuar në objektiva të sakta, ka bërë që numri i vendimeve të marra në kushte emergjence të jetë relativisht i lartë krahasuar me totalin e vendimeve të marra.

-IMK të hartojë plane dhe analiza vjetore, si dhe të përcaktojë qartë matës të performancës së veprimtarisë së saj.

-Të merren masat për përcaktimin e qartë dhe të saktë të posteve që duhet të mbajnë anëtarët e KKR dhe KSh, si dhe të numrit të tyre, për të shmangur abuzimet në ekonomikitet për sa i përket pagesës së anëtarëve të KKR.

-Të merren masa për përcaktimin e qartë të objektivave të veprimtarisë së IMK, në mënyrë që të vazhdohet të mbahet në masa të ulëta numri i vendimeve qarkulluese. Në këtë mënyrë edhe efektiviteti i vendimeve do të ishte më i lartë, duke qenë se anëtarët do të ishin të pranishëm në një masë më të madhe.

“Vazhdimisht”

15. -Menaxhimi i territorit nga pikëpamja e vlerave të TK është përballur dhe me mbivendosje të kompetencave midis institucioneve qendrore dhe vendore për çështje të planifikimit dhe administrimit të territorit në qendrat dhe zona të TK. Reformimi i këtyre institucioneve ende nuk ka dhënë frytet e veta, pasi disa prej reformave të ndërmarra në to nuk kanë dhënë rezultatet e pritshme. Kjo vihet re në përgjigjet e pyetësorëve, pasi një pjesë e stafit të sapo-rekrutuar nuk janë të mire-informuar për detyrat dhe përgjegjësitë.

-Ligji aktual nuk është i plotësuar me aktet nënligjore të dala në mbështetje të tij dhe strukturat e ASHA-ës dhe IMK, kanë hasur raste në mbivendosje kompetencash midis ASHA, IMK dhe DRKK-ve.

-Për një “Vendosje të mekanizmave të transparencës në vendim-marrje”, MK sapo ka riformatuar KKR dhe KKA. Jo cdo kërkesë për miratim të projekteve ka kaluar në të dy këshillat duke kundërshtuar detyrimin ligjor sipas të cilit Investitorët kur aplikojnë për zhvillime infrastrukturore, duhet më parë të marrin leje në KKA dhe KKR, ndërkohë që nga auditimi është konstatuar se nga KKA janë shqyrtuar gjithsej 55 kërkesa për HEC të shprehura në 55 vendime dhe nga KKR janë shqyrtuar vetëm 5 kërkesa për HEC të shprehura në 5 vendime. Rastet e kalimit në dy këshilla të kërkesave për miratimin e projekteve infrastrukturore, zgjasin tejmas proceset e shqyrtimit dhe të miratimit, duke u shoqëruar edhe me kosto për shkak të pagesave për anëtarë të jashtëm të këtyre këshillave.

MK duhet të ketë në qendër të vëmendjes eliminimin e mbivendosjes së kompetencave të institucioneve të specializuara në fushën e TK. Gjithashtu MK duhet të gjeje hapsirën ligjore në projektligjin që është duke hartuar për TK apo në akte normative të iniciuara prej saj, për përbërjen, kompetencat dhe funksionimin e një Këshilli Kombëtar, i cili të marrë në shqyrtim si rastet e propozuara nga ASHA për miratim projektsh në fushën e arkeologjisë ashtu edhe rastet e miratimit të planeve prognoze për monumentet dhe qendrat historike, studimet vlerësuese për të gjitha kategoritë e monumenteve si dhe projekteve të reastuarimit të cilat kanë kaluar me parë në KSH të IMK. Në ligj apo akt normativ të përcaktohen dhe detyrat dhe përgjegjësitë e këtij Këshilli për miratimin e projekteve të mëdha infrastrukturore si në zonat me potencial arkeologjik ashtu edhe në zonat ku ka monumente kulture.

“Menjëherë”

Grupi i auditimit
Yllka Dede
Redina Karapici
Melina Kabo

Drejtori
Rinald Muça

Tiranë, Korrik 2015

Bujar LESKAJ

